REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës:	2021:068774
Datë:	05.05.2021
Numri i dokumentit:	01755180

PKR.nr.83/21

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN-Departamenti për Krime të Rënda, me kryetarin e trupit gjykues Naser Maliqi, me sekretaren juridike Fikrete Destani, në çështjen penale kundër të pandehurit L.Z. nga Gj., të cilin e mbron mbrojtësi me autorizim av. Amir Rudaku nga Gjilani, për shkak të veprave penale: mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 paragrafi 1, posedim i paautorizuar i narkotikve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 paragrafi 1 dhe kanosje nga neni 181 paragrafi 2 i KPRK-së, duke vepruar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan-Departamenti për Krime të Rënda, me numër PP.I.nr.70/2021, të datës 27.04.2021 , pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me datë 30.04.2021, mori dhe shpalli publikisht në të njëjtën ditë , ndersa perpiloi me date 05.05.2021 këtë:

A K T GJ Y K I M

I pandehuri L.Z., nga babai H. dhe nëna V.,i lindur R., i lindur më ...., në Gj., ku edhe jeton, ka të kryer shkollën e mesmë, i pa punë, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

I.

I pandehuri L.Z.;

Sepse Me date .., rreth ores 18;50 minuta, ne rr. "...", ne Gj., i pandehuri L.Z., ne kundershtim me ligjin per armet ka mbajtur arme, dhe ate nji thike, te cilen e ekspozonte te dera e shtepise se te demtuarit L.B., pasi qe shkon dhe e kanose te njejtin, e cila thike eshte konfiskuar gjate kontrollit te shtepise se te pandehurit.

2021:081215

- Me këtë ka kryer veprën penale, mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 paragrafi 1 i KPRK-ës.

II.

Më datë .., rreth ores 19;00 minuta ne Gj., ne Lagjen "...", rr. ...", nr. 7/14, me rastin e kontrollimit te shtepise se te pandehurit L.Z., nga ana e Policise se Kosoves, tek i njejti, eshte gjetur nji cigare e mbushur me narkotik dhe pas ekzaminimit fushor, vertetohet se eshte lende narkotike e llojit "marihuan", (cigare e mbushur) me peshe prej 0.65 gr, e cila edhe i sekuestrohet.

-Me kete ka kryer vepren penale posedim i pa autorizuar i narkotikve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 paragrafi 1 te KPRK-se.

III.

Me date ..., rreth ores 18;50 minuta, nr rr. "....", ne Gj., ne lagjen e tyre, i pandehuri L.Z., e kanos seriozisht te demtuarin L.B. nga Gj.i, ne ate menyre qe , pas nji mosmarrveshje paraprake me te demtuarin Liridon, i pandehuri shkon ne shtepine e tij e merre nji thike dhe vjen te dera e shtepise se te demtuarit duke e goditur deren e shtepise, duke i thene "ku oshte kam me pre", ne kete menyre i pandehuri me veprimet e veta te i demtuari ka shkaktuar frike dhe pasiguri per jeten e tij, e me pas i demtuari ka lajmruar rastin ne polici dhe pas i njejti eshte arrestuar.

-Me kete ka kryer vepren penale kanosje nga neni 181 paragrafi 2 te KPRK-se.

Andaj, në bazë të nenit 4,38,39,40, 43,69, 73,74 , 75 dhe 76 të KPRK-ës dhe nenit 233 dhe 365 dhe 450 të KPPRK-ës:

KONSTATON

- Për veprën penale nga dispozitivi I. i këtij aktgjykimi i cakton dënim me gjobë në shumë prej 500 (peseqind) euro.
- Për veprën penale nga dispozitivi II. i këtij aktgjykimi i cakton dënim me burgim prej 500 (peseqind), euro.
- Për veprën penale nga dispozitivi III. i këtij aktgjykimi i cakton dënim me burgim prej 500 (peseqind), euro.

E GJYKON

Me dënim me gjobë në shumë prej 1.500,00 (njimijeepseqind) euro, të cilen gjobë I pandehuri do ta paguaj në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi, në të kundërtën ky dënim me gjobë

2021:081215

do të shndërrohet në denim me burg, ashtu që për çdo 20 euro të dënimit me gjobë do të llogaritet me 1 (një) ditë burgim.
Obligohet i pandehuri që në emër të paushallit gjyqësor, kësaj gjykate t'i paguajë shumën prej nga 20 euro dhe 50 (pesëdhjetë) euro për kompensimin e viktimave të krimit, të gjitha këto në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmëris së këtij aktgjykimi .
Konfiskohet: nji thike dhe substance narkotike e llojit Marihuan me peshe prej 0.65 gr., e pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi te njëjtat do të asgjësohen.

A R S Y E T I M

Prokuroria Themelore në Gjilan, Departamenti për Krime të Renda, me **dt. 27.04.2021,** ka ngritur aktakuzën **PP/I nr. 70/2021,** ndaj të akuzuarit **L.Z.** , për shkak të veprës penale **mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 paragrafi 1 te KPRK-se**,posedim I paautorizuar I narkotikve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 paragrafi 1 te KPRK-se dhe veprës penale **kanosja nga neni 181 par.4 të KPRK-së,** duke kërkuar që pas mbajatjes së shqyrtimit gjyqësor dhe administrimit të provave I pandehuri të shpallet fajtor dhe të denohet me dënim meritor sipas ligjit.
Kryetari i trupit gjykues, me datën **30.04.2021**, ka mbajtur seancën e shqytimit fillestar, në të cilën kësaj gjykate i është dorëzuar një marrëveshje mbi pranimin e fajësisë e lidhur në mes Prokurorisë Themelore në Gjilan dhe të pandehurit L.Z. nga Gjilani, me avokatin mbrojtës sipas autorizmit av. Amir Rudaku nga Gjilani.
Gjykata ka aprovuar ktë marrveshje mbi pranimin e fajësisë, pas marrjes së mendimit nga prokurori i shtetit, nga i pandehuri dhe mbrojtësit të tij.

Gjykata ka aprovuar këtë marrëveshje për pranimi të fajësisë, për shkak se ky pranim është bërë në mënyrë vullnetare, pa imponim dhe pa asnjë presion, duke i ditur pasojat e pranimit të fajsisë nga ana e të akuzuarve

Gjatë matjes dhe shqiptimit të dënimit, gjykata ka pasur parasysh sjelljen e mire të të pandehurit në gjykatë, pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit pa asnjë hezitim , pendimin për veprën e kryer dhe kërkim faljen.
Për këtë arsye u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.
I pandehuri është obliguar që në emër të paushallit gjyqësor, kësaj gjykate t'i paguajë shumën prej nga 20 euro, dhe shumën prej nga 50

2021:081215

(pesëdhjetë) euro për kompensimin e viktimave të krimit, të gjitha këto në afat prej 15 ditëve nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
Thika dhe substance narkotike jan konfiskuar. .

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
Departamenti për Krime të Rënda
Me datë 05.05.2021

Procesmbajtësja: Fikrete Destani

Kryetari i trupit gjykues: Naser Maliqi

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij akgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i paraqitet kësaj gjykate.

2021:081215